

Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k., gjatë vitit 2016

Kuadri i përgjithshëm

SiCRED Assistance sh.p.k., përgjatë vitit 2016 zgjeroi aktivitetin e saj duke shtuar në objektin e aktivitetit të saj këshillimor edhe ndërmjetësimin, si aktivitet i veçantë i kësaj shoqërie.

Qëllimi i objektit të shtuar të veprimtarisë së shoqërisë SiCRED Assistance për “ndërmjetësimin”, lidhet me shërbimin profesional të ndërmjetësimit dhe përfundimit me sukses të marrëveshjeve për veprimtari të çdo lloji natyre qofshin ato. Ky proces realizohet përkundrejt shpërblimit, i cili është përcaktuar në kontrate dhe sipas të drejtave dhe detyrimeve të shfaqura ligjërisht me vullnet të lirë nga palët.

Synim dhe objektiv i shoqërisë nën këtë parim, është edhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e institucionit shëndetësor të përshtatshëm për klientin, duke u zbatuar politikat aktive të përgjithshme të shtetit dhe duke u mbështetur shërbimi mjekësor cilësor, dhe i zgjedhur lirisht. Shoqëria ka krijuar politika të posaçme për të mbështetur këtë *synim* me rrjetin e institucioneve spitalore jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë të pajtuara me kontrate gjatë vitit 2016 dhe të cilat synon të zgjerojë edhe me tej gjatë vitit 2017.

Në optikën e shoqërisë “**ndërmjetësimi**”, u vlerësua si një proces i rëndësishëm, i cili kryesisht përcjell gatishmërinë për të marrë përgjegjësinë dhe për ta realizuar porosinë suksesshëm. I tillë implikim në këndvështrimin e shoqërisë u çmua si një tregues i drejtpërdrejtë i emrit të mirë në treg dhe i suksesit të biznesit. Në mendësinë e trupës që drejton shoqërinë, i tillë shërbim nënkupton të punosh në mënyrë të pavarur, duke marrë rreziqe dhe duke eksploruar ide të pakushtëzuara. Kushtëzimet në realizimin e këtij shërbimi, lidhen me interesat e porositësit, duke vepruar me korrektësi dhe mirëbesim, për të përmbushur vetëm udhëzimet e arsyeshme, sipas informacionit të nevojshëm që klienti ka referuar dhe vetëm për çështjet që klienti ka dhënë pëlqimin me kontratë.

Përpjekjet për të negociuar dhe për të realizuar me sukses ndërmjetësimin dhe brenda qëllimeve të ligjshme të shfaqura me vullnet të lirë në kontrate, çmuam se shtojnë vlerat e klientëve tanë, e njëkohësisht edhe emrin e mirë të shoqërisë.

Ky mentalitet sipërmarrës është pjesë e objektivave të shoqërisë, si dhe anëtareve të ekipit, që i janë bashkuar në këtë sipërmarrje që nga themelimi i saj viti 2012.

“*Ndërmjetësimi në punësim*”, si një tjetër aspekt specifik i shërbimeve të ndërmjetësimit, u konsiderua sfidë e re për shoqërinë dhe nga pikëpamja e drejtimit u vlerësua dhe u mbështet, si një mundësi më shumë, për zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë në treg. Drejtimi i shoqërisë duke marrë nën konsideratë kërkesat e tregut vendas për të ofruar shërbime ndërmjetësimi, dhe në mënyrë të posaçme shërbime ndërmjetësimi në punësim, të cilat u gjykuan se lidhen natyrshëm dhe me këshillimin ligjor dhe trajtimin e çështjeve

të sigurisë dhe të shëndetit në punë, nën cilësinë e personit juridik privat aplikoi në instancat shtetërore për marrje licence “*ndërmjetësim punësim*” dhe në përfundim të vlerësimit nga organi përgjegjës shtetëror, suksesshëm u aprovua licenca përkatëse.

Shoqëria synoi që nëpërmjet kësaj shtese në aktivitet, të mundësohej ndërmjetësimi në punësim e në këtë proces të rregullohej edhe punësimi i të huajve punëkërkuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Të bindur që aktiviteti bazë, me një historik pozitiv eksperience do të ndihmohej nga ky aktivitet shtesë, duke i parë të tilla procese, si veprimtari komplementare, të cilat prekin sferën e punësimit në tërësi, u gjykua që e tillë shtesë do të ishte një tjetër oportunitet që do të mbështeste ecurinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë.

Shërbimi i ndërmjetësimit në punësim nga shoqëria SiCRED Assistance sh.p.k.; garanton me pagesë ndërmjetësim për punë, për punëdhënësit dhe punëkërkuar në të gjithë territorin e vendit. Kjo shoqëri mbështetet tek përgatitja e posaçme e punonjësve të saj për të kryer ndërmjetësimin për punë cilësisht dhe në mënyrë efektive. Shërbimet e punësimit dhe ndërmjetësimit në punësim, në objektin e shtuar të shoqërisë SiCRED Assistance sh.p.k.; identifikohen me veprimtaritë e mëposhtme:

- a) Informim për vendet e lira të punës.
- b) Ndërmjetësim për punësim.
- c) Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion.
- d) Informacion dhe këshillim.
- e) Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës apo të profesionit metodika për punësim.
- f) Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës nëpërmjet trajnimit dhe ndërhyrjeve në përmirësimin e legjislacionit të tregut të punës.
- g) Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahet për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin, apo shërbime ndërmjetësimi të pa lidhura ngushtësisht me çështjet e vetëm punësimit etj..
- gj) ndërmjetësim në punësim dhe këshillim për shërbimet e migracionit (emigrimit dhe imigrimit). Në çështjet e “Imigrimit”, ofrohet këshillim ligjor dhe ndërmjetësim në punësim në kuadër të përcaktimeve të ligjit nr.108/2013; datë 28.03.2013 “Për të Huajt”, i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve nga Republika e Shqipërisë. Referuar vete subjekteve të mire përcaktuara në këtë ligj janë identifikuar të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim *tranzitimin*, punësimin, studimin apo ri-pranimin.

Të vëmendshëm ndaj standardit dhe kërkesave ligjore dhe si një subjekt privat, i cili në mënyrë private dhe për qëllime fitimi do te kryejë shërbime ndërmjetësimi në punësime, duke respektuar standardet ligjore shoqëria, ndërtoi modelet e kontratave të ndërmjetësimi në punësim, si dhe protokollet e komunikimit edhe me subjekte të regjistruara jashtë kufijve, që ofronin shërbime ndërmjetësimi në punësim përtej vendit të tyre të origjinës.

Me gjithë *kompleksitetin* që bart ky proces shoqëria ka në objektiv të realizojë kontratat e saj të para, lidhur me ndërmjetësimin në punësim, gjatë vitit pasues 2017, duke ruajtur imazhin e mirë të krijuar nga aktiviteti i këshillimit disa vjeçar për çështjet e punësimit dhe sigurisë në punë. Synimi i shoqërisë është që të zgjerohet baza e klientëve të saj dhe të rritet besimi publik se shoqëria është e aftë të këshillojë dhe të ndërmjetësojë privatisht shërbime punësimi duke respektuar ligjin, e duke promovuar metodologjitë me të mira të vendeve të zhvilluara, ku ky aktivitet ka vite që lulëzon.

Nuk mund të lemë pa përmendur faktin që në aktivitetin bazë-primar viti 2016, shënoi vitin e projektimit, dhe vlerësimit të raportit të riskut në mjediset e punës. Me anë të këtij akti u mundësua edhe zgjerimi i bazës së klientëve të shoqërisë edhe u dhanë prova që shoqëria në mënyrë të kujdesshme, korrekte, dhe profesionale referoi problematikat e hasura në mjediset e punës që hetoi pranë punëdhënësit dhe adresoi profesionalisht rekomandimet sipas natyrës së hasur, rëndësisë e urgjencës për ndërhyrje.

Ecuria e aktivitetit gjatë 2016

Përmbledhtazi në fund të vitit 2016, afirmojmë se shoqëria e përmbylli vitin krahasuar me vitet e mëhershme me progres pozitiv me ekspansion në tregun e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke shënuar klientë të rinj, edhe duke realizuar progres të dukshëm në realizimin e të ardhurave nga aktiviteti deri në fund të vitit 2016.